

VENDIM
Nr. 533, datë 8.7.2020

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 313, DATË 1.7.2002, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR ÇAKTIMIN E STRUKTURËS, TË NUMRIT
TË PUNONJËSVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE TË POLICISË SË
BASHKISË DHE KOMUNËS”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 17, të ligjit nr. 8224, datë 15.5.1997, “Për organizimin dhe funksionimin e policisë së bashkisë dhe komunës”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në lidhjen bashkëlidhur vendimit nr. 313, datë 1.7.2002, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Në pikën 19, të kreut XXXIV, numri maksimal i punonjësve të Policisë Bashkiake, për Bashkinë Tiranë, bëhet 500 (pesëqind) veta.

2. Numri i përgjithshëm i punonjësve të Policisë Bashkiake bëhet, gjithsej, 1 387 (një mijë e treqind e tetëdhjetë e shtatë) veta.

II. Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama